



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:081872  
Datë: 20.08.2024  
Numri i dokumentit: 06067907

P.nr.194/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e vetme gjyquese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: I.D, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit (Nr.06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.311/23, të datës 03.04.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 08.08.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit I.D dhe mbrojtësit të tij Av. Ardit Rifaj, në po të njëjtën ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I.D lindur me datën .... në P..., me vendbanim në: D..., nga i ati I... dhe nëna Z... e gjinisë B..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer Fakultetin, i identifikuar me numër personal: ....., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datën 12.01.2023, në orën e pa përcaktuar, në Mitrovicë, e kanos me fjalë seriozisht personin tjetër-të dëmtuarin E.A duke i shënuar mesazhe përmes rrjeteve sociale Facebook me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit tek i njëjti, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri I.D, menaxher në bankën .... në D..., i ka dërguar mesazhe të dëmtuarit duke i shkruar se do t'ia bllobojë shtëpinë e tij në fshatin B... KK D..., duke ja bllokuar, pastaj duke i shkruar se do të arrestojnë policia posa të tentosh të largohesh nga Republika e Kosovës, dhe duke i shkruar se do të takohet më të njëjtin privatisht, këto mesazhe i pandehuri ia ka dërguar të dëmtuarit më

arsyetim se motra e ankuesit N... ka marrë një kredi prej 1000 €uro në bankën ...në D..., ku i dyshuari është menaxher, dhe se ajo është vonuar në pagesën e këstit të parë dhe nga i dëmtuari ka kërkuar që të filloj të paguaj kredinë të cilën e ka marrë motra e tij, dhe nëse nuk e paguan do të këtë pasoja, ku si pasojë e kanosjes tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit për vete dhe të anëtarit të tij të familjes, ashtu që e lajmëron rastin në polici.

Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 69, 70, e 181 par.21 të KPRK-ës, dhe neni, 364, 276, 449, të KPP-së, i:

## S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumën prej 200€ (dyqind euro), i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- III. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar E.A për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

## A R S Y E T I M

### Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.311/23, të datës 03.04.2023, ndaj të pandehurit I.D, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

### Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 08.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Ajtene Zoni, të pandehurit I.D dhe mbrojtësit të tij Av. Ardit Rifaj.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues. Kërkoj falje për rastin e ndodhur, duke shprehur e pendim për atë që ka ndodhur, si dhe gjykatës i premtoi se më nuk do të përsërisë kurrë këtë.

Gjykata ka marrë mendimin nga prokurori i rastit mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Prokurori i shtetit, propozoi gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë, pasi është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, si dhe pranimi i fajësisë është në përputhje me provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës.

### Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri I.D, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje në polici e të dëmtuarit/dëshmitarit E.A me datën 13.01.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të pandehurit I.D me datën 14.02.2023; SMS komunikimet me shkrim, në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit, Raporti i policit Mihajloviç Sasha #5233, i datës 13.01.2023; dhe Raporti i policit Bajram Sejdiu #6755, i datës 17.03.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

#### Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin I.D, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, Gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, faktin se veprat e tilla penale, janë gjithnjë e më të shpeshta në vendin tonë.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, kërkim faljen e dhënë para gjykatës dhe pendesën e shprehur për rastin e ndodhur, premtimin e dhënë para Gjykate se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, faktin se i njëjti është i pa gjykuar më parë. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që

t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 276, 449, të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.194/2023, datë 20.08.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja

Qëndresa Tahiri Islami

**KËSHILË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.